

Transparenca dhe zbatimi i rregullimit të çmimeve të produkteve medicinale në Kosovë

Korrik, 2026



AUTORË:

Ardit Dragusha & Leorenta Alija



Vizitoni webfaqen tonë
www.dplus.org

Zbuloni më shumë për publikimin tonë të fundit,
lajmet, infografikat online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@Democracy Plus](https://www.youtube.com/DemocracyPlus)

Zyrat tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92, Kati IV
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Përmbledhje ekzekutive

Miratimi i Ligjit Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale shënoi një reformë të rëndësishme në rregullimin e tregut farmaceutik në Kosovë. Edhe pse rregullimi i çmimeve ishte paraparë më herët përmes legjislacionit dytësor, për herë të parë kjo fushë u rregullua me ligj, duke krijuar një kornizë më të qartë dhe më të qëndrueshme për përcaktimin dhe zbatimin e çmimeve të produkteve medicinale¹. Ligji synon nivelizimin e çmimeve në të gjitha barnatoret, rritjen e transparencës së tregut dhe standardizimin e procesit të përcaktimit të çmimeve. Megjithatë, zbatimi i tij ka nxjerrë në pah një sërë sfidash praktike, institucionale dhe rregullatore, të cilat kanë ndikuar në funksionimin e tregut farmaceutik dhe në zbatimin efektiv të reformës.

Ky hulumtim trajton zbatimin e Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale, me fokus në funksionimin e mekanizmit të rregullimit të çmimeve, ndikimin e tij në tregun farmaceutik dhe sfidat e evidentuara gjatë zbatimit. Analiza mbështetet në shqyrtimin e kuadrit ligjor dhe dokumenteve publike, analizën e të dhënave dhe kontratave të prokurimit publik, intervistat me institucionet përgjegjëse dhe palët e interesit, si dhe rezultatet e një ankete të realizuar me qytetarë. Në bazë të këtij procesi, të gjeturat kryesore janë si në vijim:

- Deri në miratimin e Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale, mungesa e një mekanizmi funksional për rregullimin e çmimeve u karakterizua me dallime të konsiderueshme të çmimeve, përdorim joefikas të fondeve publike dhe stimuj për kontrabandimin e produkteve medicinale.
- Ligji për Çmimin e Produkteve Medicinale krijoi një kornizë të standardizuar për nivelizimin e çmimeve të produkteve medicinale, me synim që konkurrenca ndërmjet barnatoreve të bazohet në cilësinë e shërbimit dhe këshillimin profesional, e jo në dallimet në çmime.

Ky hulumtim trajton zbatimin e Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale, me fokus në funksionimin e mekanizmit të rregullimit të çmimeve, ndikimin e tij në tregun farmaceutik dhe sfidat e evidentuara gjatë zbatimit. Analiza mbështetet në shqyrtimin e kuadrit ligjor dhe dokumenteve publike, analizën e të dhënave dhe kontratave të prokurimit publik, intervistat me institucionet përgjegjëse dhe palët e interesit, si dhe rezultatet e një ankete të realizuar me qytetarë.

- Kalimi i një periudhe të konsiderueshme ndërmjet pas hyrjes në fuqi të ligjit evidentoi se kapacitetet administrative, teknike dhe digjitale janë faktorë përcaktues për funksionalizimin efektiv të reformave rregullatore.
- Mungesa e një fushate gjithëpërfshirëse të informimit publik ka kufizuar qytetarët të kuptojnë më mirë ndryshimet e sjellura nga ligji dhe mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të tyre, duke ndikuar në perceptimin se nivelizimi i çmimeve nuk është arritur në praktikë.
- Kapacitetet monitoruese për zbatimin e ligjit janë forcuar përmes rritjes së numrit të inspektorëve dhe intensifikimit të kontrolleve, megjithatë ligji ende nuk përcakton qartë se cili inspektorat ka mandatin për mbikëqyrjen e zbatimit të tij. Gjatë vitit 2025 u realizuan 2,222 inspektime nga Inspektorati Farmaceutik, prej të cilave 738 në barnatore dhe 52 në depot farmaceutike, si dhe 265

¹ Rregullimi i çmimeve të produkteve medicinale ishte paraparë edhe me Udhëzimin Administrativ (në Shëndetësi) Nr. 02/2019 për Rregullimin e Çmimit të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale. Megjithatë, ky akt nuk u zbatua në praktikë dhe u shfuqizua me Vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë me Nr. 642/VIII/2020.

inspektive në kuadër të Praktikave të Mira Farmaceutike ku u verifikua edhe vendosja e banderolës. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 u realizuan edhe 857 inspektive, përfshirë 259 kontrolle të elementeve të banderolës.

- Modeli aktual mbështetet ekskluzivisht në metodologjinë e referencës së jashtme të çmimeve dhe nuk parashikon mekanizma alternativë të negociimit të drejtpërdrejtë, duke kufizuar fleksibilitetin e sistemit për t'iu përgjigjur situatave të veçanta në furnizimin me produkte medicinale.
- Marzha maksimale prej 7.5% për qarkullimin me shumicë, e kombinuar me mungesën e një definimi të qartë të “shpenzimeve të tjera vartëse”, mund të mos reflektojë kostot reale të furnizimit dhe të ndikojë në interesin e operatorëve për të mbajtur në treg produkte me volum të ulët ose kosto më të larta. Kjo mund të krijojë rrezik për tërheqjen e disa produkteve nga tregu dhe të ndikojë në sigurinë e furnizimit, çka ilustron edhe nga tërheqja e autorizimeve të marketingut për 33 produkte origjinatore gjatë vitit 2026.
- Ligji nuk rregullon qartë trajtimin e produkteve që tashmë janë pajisur me banderolë kur çmimet përditësohen përmes Listës Zyrtare të Çmimeve. Si rezultat, mund të krijohen mospërputhje ndërmjet çmimit të shtypur në banderolë dhe çmimit të publikuar në listën e përditësuar, pa përcaktuar qartë se cili çmim ka përparësi në zbatim. Kjo krijon pasiguri juridike për operatorët ekonomikë dhe organet mbikëqyrëse, ndërsa mungesa e një sistemi funksional Track & Trace kufizon monitorimin efektiv të zbatimit të çmimeve përgjatë zinxhirit të furnizimit.
- Përfshirja e barnave OTC (Over-the-Counter) në sistemin e rregullimit administrativ të çmimeve zgjeron ndërhyrjen rregullatore edhe në segmente të tregut që funksionojnë në kushte më të larta konkurrence. Kjo ngre nevojën për të rishqyrtuar proporcionalitetin e modelit aktual dhe

për të diferencuar qasjen rregullatore sipas kategorive të produkteve medicinale, në përputhje me praktikën evropiane që fokusojnë kontrollin e çmimeve kryesisht te barnat me recetë dhe ato të financuara nga fondet publike.

- Ligji centralizon një numër të konsiderueshëm kompetencash te Ministri i Shëndetësisë, megjithëse përcaktimi i çmimeve është një proces teknik i bazuar në metodologji të standardizuara. Në të njëjtën kohë, ligji nuk përcakton qartë elementet që duhet të rregullohen përmes akteve nënligjore, duke kufizuar fleksibilitetin e sistemit për t'iu përshtatur sfidave të zbatimit pa ndryshime në vetë ligjin.
- Hyrja në fuqi e këtij ligji u shoqërua me një “shok” fillestar në treg, duke shkaktuar mungesa të përkohshme të disa produkteve medicinale. Megjithëse shkaqet e këtyre mungesave u vlerësuan ndryshe nga institucionet dhe operatorët ekonomikë, gjetjet sugjerojnë se ato lidhen kryesisht me fazën tranzitore të zbatimit dhe përshtatjen me kërkesat e reja ligjore.
- Rregullimi i çmimeve, në vetvete, nuk ofron dëshmi të mjaftueshme se ka reduktuar kontrabandimin e produkteve medicinale. Të dhënat mbi konfiskimet tregojnë se kontrabanda mbetet e pranishme, ndërsa efektiviteti i politikës së çmimeve varet edhe nga mekanizmat e mbikëqyrjes së tregut, koordinimi ndër-institucional dhe funksionalizimi i sistemit Track & Trace për gjurmueshmërinë e produkteve përgjatë zinxhirit të furnizimit.

1. Rregullimi i çmimit të produkteve medicinale në Kosovë

1.1 Ligji për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale

Ligji për Çmimin e Produkteve Medicinale rregullon metodologjinë për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale në Kosovë, e bazuar në metodologjinë e referencës së jashtme të çmimeve. Çmimi përcaktohet individualisht për secilin produkt medicinal mbi bazën e deklarimit të bërë nga bartësi i autorizimit për marketing ose përfaqësuesi i tij i autorizuar në Kosovë. Deklarimi i çmimit me shumicë është i detyrueshëm për të gjitha produktet që posedojnë autorizim marketingu dhe, si rregull, bëhet një herë në vit, ndërsa për produktet e reja paraqitet njëkohësisht me aplikimin për autorizim marketing.

Mbi bazën e të dhënave të deklaruara dhe metodologjisë së përcaktuar në ligj, platforma elektronike llogarit automatikisht çmimin maksimal me shumicë, ndërsa Komisioni për Çmimin e Produkteve Medicinale verifikon përputhshmërinë e të dhënave dhe procedurës. Çmimi përcaktohet sipas një renditjeje të paracaktuar të burimeve referente: fillimisht përdoren çmimet nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroacia dhe vendi i origjinës, mbi bazën e mesatares së dy çmimeve më të ulëta; në mungesë të tyre përdoret shporta e dytë referente (Sllovenia, Estonia, Bullgaria dhe vendi i origjinës), ndërsa më pas çmimi më i ulët i disponueshëm nga një shtet i Bashkimit Evropian. Çmimi CIP²³ ose çmimi i deklaruar nga bartësi i autorizimit merren në konsideratë vetëm nëse rezultojnë më të ulët se çmimi i llogaritur sipas metodologjisë.

1.2 Pse u miratua Ligji për Çmimin e Produkteve Medicinale?

Për më shumë se dy dekada, Kosova nuk kishte një mekanizëm funksional për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale. Si rezultat, çmimet e të njëjtit produkt ndryshonin ndërmjet barnatoreve, duke krijuar pabarazi në qasjen e qytetarëve në barna, barrë financiare për pacientët dhe mungesë transparence në tregun farmaceutik. Mungesa e një sistemi të unifikuar të çmimeve ndikonte gjithashtu në përdorimin e fondeve publike, pasi institucionet publike kontraktin produkte medicinale me çmime më të larta se ato të tregut⁴. Në të njëjtën kohë, diferencat e konsiderueshme të çmimeve ndërmjet Kosovës dhe vendeve të rajonit krijojnë stimuj për kontrabandimin e barnave dhe dobësonin integritetin e zinxhirit të furnizimit⁵.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, në vitin 2023 u miratua Ligji Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale, i cili vendosi një sistem të rregullimit dhe nivelizimit të çmimeve të bazuar në metodologjinë e referencës së jashtme të çmimeve⁶. Objektivi kryesor i ligjit është që i njëjti produkt medicinal të shitet me të njëjtin çmim në të gjitha barnatoret, në mënyrë që qytetarët ta zgjedhin barnatoren bazuar në cilësinë e shërbimit farmaceutik dhe këshillimin profesional, e jo në kërkimin e çmimit më të ulët. Pavarësisht në diskursin publik ligji u prezantua edhe si një mekanizëm për uljen e çmimeve, qëllimi i tij parësor është standardizimi dhe transparenca e çmimeve në tregun farmaceutik.

2 Shporta 1 dhe 2 nuk mund të kombinohen mes vete. Vendi i origjinës nuk mund të përdoret si çmim i vetëm.

3 Çmimi CIP (Carriage and Insurance Paid to), është çmimi që përfshin transportin dhe sigurimin e paguar deri në vendin e destinimit.

4 Ministria e Shëndetësisë paguan rreth 280% më shtrenjtë produktin Paracetamol 1 gr për injeksion në krahasim me vlerën e tregut me pakicë. Instituti Demokratik i Kosovës. Gjetet në: <https://telegrafi.com/kdi-thote-se-ms-ja-blen-paracetamol-shumefish-te-shtrenjte-sesa-qe-shitet-ne-kosove/>.

5 Barnat e kontrabanduara nëpër barnatoret e Kosovës. Radio Evropa e Lirë. Gjetet në: <https://www.evropaelire.org/a/barnat-e-kontrabanduara-neper-barnatoret-e-kosoves-/29851397.html>.

6 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=79015>.

2. Problemet me rregullimin e çmimit të produkteve medicinale

Rregullimi i çmimeve të produkteve medicinale përmes ligjit është vlerësuar si një reformë e nevojshme dhe ka sjellë efekte pozitive në praktikë. Përkundër këtyre rezultateve, ky hulumtim evidenton edhe disa mangësi në zbatimin e tij, të cilat trajtohen në vijim.

2.1 Kufizimet e metodologjisë së referencës së jashtme të çmimeve

Metodologjia e referencës së jashtme mbështetet ekskluzivisht në krahasimin e çmimit të të njëjtit produkt medicinal nga i njëjti prodhues, pa mundur të përdorim të produkteve gjenerike ekuivalente si referencë. Si rezultat, produktet që tregtohen vetëm nga një vend i rajonit, ose produktet vendore, mund të mbeten pa referencë të mjaftueshme për vlerësimin e çmimit. Rrjedhimisht, në këto raste çmimi mund të përcaktohet mbi një bazë të kufizuar krahasuese, duke ulur saktësinë e referencimit dhe efektivitetin e modelit në segmentet e tregut ku konkurrenca është e kufizuar.

2.2 Fleksibiliteti i modelit në përcaktimin e çmimeve

Modeli aktual i rregullimit të çmimeve mbështetet në një metodologji të standardizuar të referencës së jashtme dhe nuk parasheh mekanizma që i mundësojnë shtetit negociimin e drejtpërdrejtë të çmimeve me kompanitë farmaceutike. Si rrjedhojë, korniza aktuale ofron fleksibilitet të kufizuar për në situata të interesit të veçantë publik, përfshirë emergjencat shëndetësore.

Përvoja ndërkombëtare tregon se në rrethana të tilla përdoren mekanizma të negociimit të drejtpërdrejtë me prodhuesit, praktikë që është ndjekur edhe nga Kosova gjatë pandemisë COVID-19, kur Qeveria arriti marrëveshje të drejtpërdrejtë me kompaninë Pfizer për furnizimin me vaksina kundër COVID-19⁷.

2.3 Implikimet e modelit aktual të rregullimit të çmimeve

Modeli aktual i rregullimit të çmimeve synon të rrisë përballueshmërinë dhe transparencën e tregut farmaceutik, por njëkohësisht mund të krijojë implikime për funksionimin e tregut dhe sigurinë e furnizimit, veçanërisht në një treg të vogël si Kosova. Në segmentet ku konkurrenca është e kufizuar ose vëllimi i shitjes është i ulët, prodhuesit mund të kenë interes më të vogël për të furnizuar tregun kosovar, sidomos për me kërkesë të kufizuar. Diferencat e mëdha të çmimeve ndërmjet Kosovës dhe vendeve të tjera mund të ndikojnë gjithashtu në strategjitë rajonale të çmimeve të kompanive farmaceutike.

Për shembull, nëse një prodhues e shet të njëjtin produkt me çmim dukshëm më të ulët në Kosovë sesa në vendet fqinje, ai mund të vlerësojë se ky dallim cenon strategjinë e tij rajonale të çmimeve, pasi çmimi në Kosovë mund të përdoret si pikë reference ose të krijojë presion për uljen e çmimeve edhe në tregje të tjera⁸. Gjatë vitit 2026 janë identifikuar edhe raste të tërheqjes së autorizimeve të marketingut për 33 produkte origjinatore të kompanive ndërkombëtare, pas përcaktimit të çmimeve sipas modelit të ri⁹. Megjithatë këto raste nuk mund t'i atribuohen në

7 "Pfizer konfirmon marrëveshjen me Kosovën për vaksina". Radio Evropa e Lirë. Gjetet në: <https://www.evropaelire.org/a/pfizer-konfirmon-marrëveshjen-per-vaksina-me-kosoven/31280001.html>.

8 Aktualisht, Kosova nuk shërben si vend referent për asnjë shtet tjetër në kuadrin e sistemit të referimit ndërkombëtar.

9 E dhënë e prezantuar nga Virtyte Krasniqi Shala, Drejtoreshë e Departamentit për Autorizim të Marketingut, Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), dhe anëtare e Komisionit për Caktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale në diskutimin tematik të datës 28.07.2026.

mënyrë përfundimtare vetëm politikës së çmimeve, ato sugjerojnë se niveli i çmimeve dhe marzhat e kufizuara mund të ndikojnë në vendimet komerciale të disa prodhuesve për të vazhduar furnizimin e tregut kosovar.

Një element tjetër i modelit lidhet me trajtimin e kostove të qarkullimit me shumicë. Ligji përcakton se pjesë përbërëse e çmimit me shumicë është marzha e qarkullimit me shumicë dhe “shpenzimet e tjera vartëse”¹⁰. Megjithatë, korniza ligjore nuk definon në mënyrë të qartë se cilat kosto përfshihen në kategorinë e “shpenzimeve të tjera vartëse” dhe as metodologjinë për llogaritjen e tyre. Në praktikë, distributorët farmaceutik raportojnë se këto kosto mund të përfshijnë tarifa për lejet e importit, banderolat, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e autorizimit të marketingut, licencimin e depove farmaceutike, si dhe kosto operative si transporti, magazinimi, qiraja dhe pagat. Mungesa e një definimi të qartë dhe e një metodologjie për reflektimin e këtyre kostove në çmimin përfundimtar mund të kufizojë aftësinë e modelit për të pasqyruar kostot reale të furnizimit, veçanërisht për operatorët që tregtojnë produkte me volum të ulët ose me kosto më të larta operative.

Këto implikime bëhen edhe më të rëndësishme në mungesë të një sistemi funksional të sigurimeve shëndetësore, pasi shteti nuk disponon mekanizma shtesë, si negociimi ose kontraktimi i centralizuar, për të balancuar objektivin e përballueshmërisë së çmimeve me qëndrueshmërinë e furnizimit me produkte medicinale.

2.4 Monitorimi i çmimeve gjatë qarkullimit të produkteve medicinale

Modeli aktual i rregullimit të çmimeve siguron kontroll të fortë në hyrje të tregut, pasi produktet medicinale mund të qarkullojnë vetëm pas përcaktimit të çmimit dhe pajisjes me banderolën përkatëse. Korniza aktuale ofron

mekanizma më të kufizuar për monitorimin e çmimeve pas vendosjes së produkteve në qarkullim. Ligji nuk rregullon në mënyrë të plotë trajtimin e stoqeve ekzistuese në rast të ndryshimit të çmimeve, ndërsa mungesa e një sistemi funksional Track & Trace¹¹ kufizon gjurmueshmërinë e produkteve përgjatë zinxhirit të furnizimit dhe mundësinë e monitorimit në kohë reale të zbatimit të çmimeve.

Ligji obligon barnatoret që produktet medicinale t’i shesin sipas çmimit të përcaktuar nga Komisioni, ndërsa njëkohësisht kërkon që çmimi me pakicë të jetë i vendosur në banderolë në ambalazhin e jashtëm të produktit¹². Në praktikë, çmimi i përcaktuar nga Komisioni mund të ndryshojë me përditësimin e Listës Zyrtare, ndërkohë që produktet tashmë të pajisura me banderolë vazhdojnë të qarkullojnë me çmimin e shtypur fillimisht dhe nuk ekzistojnë mundësia e përditësimit të çmimit në banderola, pavarësisht se çmimi duhet të jetë në përputhje me Listën Zyrtare të Çmimeve të përditësuar. Si rezultat, mund të krijohen situata ku çmimi në banderolë nuk përputhet me çmimin e publikuar në Listën Zyrtare, pa qenë e qartë se cili çmim duhet të ketë epërsi në praktikë.

Për të adresuar këtë boshllëk, Plan i Institucional i Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2026 dhe Strategjia për Zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor 2024–2030 parashohin zhvillimin e një platforme kombëtare Track & Trace¹³. Megjithatë, pavarësisht planifikimit institucional, deri më tani nuk ka dëshmi publike për funksionalizimin e këtij sistemi, duke lënë të pazgjidhur një element kyç të mbikëqyrjes së tregut farmaceutik.

2.5 Përfshirja e produkteve OTC në sistemin e rregullimit të çmimeve

Një çështje që ngrihet në nivel të dizajnit të politikës lidhet me përfshirjen e produkteve OTC (Over-the-Counter), pra barnave që shiten pa recetë, në sistemin e rregullimit të çmimeve¹⁴. Përfaqësuesit e institucione-

10 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale. Neni 9, paragrafi 10. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=79015>.

11 Track & Trace është sistem digjital i gjurmueshmërisë së barnave, i cili mundëson identifikimin dhe monitorimin e çdo produkti medicinal përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit, nga importi ose prodhimi deri te pacienti, me qëllim rritjen e transparencës, kontrollit dhe sigurisë së tregut farmaceutik.

12 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale. Neni 11, paragrafi 6 dhe 7. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=79015>.

13 Ministria e Shëndetësisë. Plan i Institucional për vitin 2026. Gjetet në: <https://msh.rks-gov.net/Home/SearchSubService?text=plani%20institucional>.

14 OTC (Over-the-Counter) – Barna që shiten pa recetë mjekësore dhe që, në shumicën e vendeve evropiane, nuk i nënshtrohen rregullimit administrativ të çmimeve.

ve dhe sektorit farmaceutik vlerësojnë se kjo kategori produktesh funksionon në një segment më konkurrues të tregut dhe, për dallim nga barnat me recetë, nuk lidhet drejtpërdrejt me objektivat e politikës për garantimin e qasjes në trajtim ose kontrollin e shpenzimeve publike për shëndetësi.

Në këtë kontekst, përfshirja e tyre në mekanizmin e rregullimit të çmimeve ngre çështjen e proporcionalitetit të ndërhyrjes rregullatore dhe të nevojës për të diferencuar instrumentet e politikës sipas karakteristikave të kategorive të ndryshme të produkteve medicinale. Kjo qasje reflektohet edhe në praktikat e shumë vendeve evropiane, ku rregullimi administrativ i çmimeve fokusohet kryesisht te barnat me recetë dhe produktet që financohen ose rimbursohen nga fondet publike, ndërsa çmimet e produkteve OTC zakonisht përcaktohen nga mekanizmat e tregut¹⁵.

2.6 Përjashtimi i produkteve pa autorizim marketingu nga metodologjia e referencës së jashtme

Një çështje tjetër që lidhet me dizajnin e modelit të rregullimit ka të bëjë me trajtimin e produkteve medicinale pa autorizim marketingu¹⁶, të importuara sipas legjislacionit përkatës. Për dallim nga produktet që i nënshtrohen metodologjisë së referencës së jashtme të çmimeve, për këtë kategori ligji parashikon që çmimi të përcaktohet duke i shtuar çmimit të importit (CIP) marzhën e qarkullimit me shumicë dhe shpenzimet e ndërlidhura, deri në kufirin prej 7.5%, ndërsa importuesi obligohet ta deklarojë çmimin gjatë aplikimit për leje importi¹⁷. Si rezultat, kjo kategori produktesh përjashtohet nga metodologjia e përgjithshme e referencës së jashtme të çmimeve dhe, rrjedhimisht, nga mekanizmi i nivelizimit të çmimeve që zbatohet për produktet medicinale me autorizim marketingu.

2.7 Procedura e miratimit dhe përditësimit të Listës Zyrtare të Çmimeve

Korniza ligjore centralizon në masë të konsiderueshme kompetencat vendimmarrëse te Ministri i Shëndetësisë, edhe pse përcaktimi i çmimeve është konceptuar si proces teknik i bazuar në metodologji të standardizuar dhe i administruar përmes platformës elektronike. Përveç emërimit të Komisionit për Çmimin e Produkteve Medicinale, ministri miraton Listën Zyrtare të Çmimeve, përcakton me vendim procedurat dhe formatin e deklarimit dhe rideklarimit të çmimeve, rregullat e funksionimit të Komisionit, si dhe autorizohet të nxjerrë vendime për çështje procedurale, administrative dhe teknike që lidhen me zbatimin e ligjit¹⁸. Si rezultat, funksionimi i mekanizmit të përcaktimit të çmimeve mbetet në masë të madhe i lidhur me ushtrimin e këtyre kompetencave nga ministri, ndonëse vendimmarrja për çmimet mbështetet në një metodologji të paracaktuar me ligj dhe në verifikime me karakter teknik.

Në të njëjtën kohë, ligji nuk përcakton në mënyrë të shprehur elementet që duhet të rregullohen përmes akteve nënligjore dhe nuk krijon një kornizë të qartë delegimi normativ për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit. Megjithatë ministri autorizohet të nxjerrë vendime për çështje procedurale, administrative dhe teknike, mungesa e një delegimi më të strukturuar për aktet nënligjore kufizon mundësinë që çështjet e reja të zbatimit të adresohen përmes rregullimit sekondar. Si rrjedhojë, ndryshimet ose sqarimet e elementeve të caktuara të sistemit mund të kërkojnë ndërhyrje në vetë ligjin, duke e bërë kuadrin rregullator më pak fleksibil ndaj sfidave praktike të zbatimit.

15 Klasifikim sasior i modeleve të rregullimit të barnave OTC në 30 vende evropiane: kufizimet në dhënien e barnave, distribuimi, pronësia e barnatoreve dhe sistemet e rregullimit të çmimeve". Springer Nature. Gjetet në: <https://link.springer.com/article/10.1186/s40545-023-00522-7>.

16 Produktet pa paralele (ose produktet medicinale pa paralele) janë barna ose produkte mjekësore që importohen dhe përdoren në një vend pa pasur një Autorizim Marketingu të rregullt dhe të plotë, por që lejohen përkohësisht për të mbuluar mungesat në treg.

17 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale. Neni 9, paragrafi 10 dhe 11. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=79015>.

18 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale. Neni 17. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=79015>.

3. Monitorimi i zbatimit të ligjit

Edhe pse Lista Zyrtare e Çmimeve hyri në fuqi më 1 shkurt 2025, zbatimi i ligjit gjatë muajve të parë u shoqërua me një sërë sfidash praktike. Procesi u karakterizua nga vështirësi në përshtatjen me metodologjinë e re të përcaktimit të çmimeve, sfida në furnizimin me disa produkte medicinale dhe paqartësi lidhur me trajtimin e stoqeve ekzistuese. Në të njëjtën kohë, perceptimet e qytetarëve tregojnë se dallimet në çmimet e të njëjtit produkt medicinal ndërmjet barnatoreve vazhduan të evidentohen, duke ngritur pikëpyetje mbi konsistencën e zbatimit të ligjit në praktikë.

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale gjatë fazës fillestare u karakterizua nga një qasje graduale, me fokus në informimin dhe përshtatjen e distributorëve farmaceutik me kërkesat e reja ligjore. Sipas institucioneve përgjegjëse, prioritet iu dha ndërgjegjësimi, identifikimi të parregullsive dhe harmonizimit gradual me sistemin e ri të rregullimit të çmimeve, me qëllim që të mos aplikohen masa ndëshkuese. Kjo qasje u zhvillua paralelisht me një paqartësi të vetë kornizës ligjore, pasi neni 15 i Ligjit përcakton vetëm se “mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji bëhet nga inspektorati përkatës sipas ligjeve në fuqi”, pa specifikuar në mënyrë të qartë institucionin përgjegjës për ushtrimin e këtij mandati.

Si rezultat, mbikëqyrja në praktikë është realizuar përmes koordinimit ndërmjet Inspektoratit Farmaceutik dhe Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT), të cilët kanë zhvilluar edhe inspektime të përbashkëta në kuadër të zbatimit të ligjit. Paralelisht me fillimin e zbatimit të ligjit, janë ndërmarrë edhe masa për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, përfshirë dyfishimin e numrit të inspektorëve farmaceutikë nga 11 në 22, si dhe përmirësimin e kapaciteteve logjistike për inspektimet në terren¹⁹.

GJATË VITIT 2025

Inspektorati Farmaceutik realizoi

2,222 inspektime

prej të cilave **738** kishin për objekt kontrollin e zbatimit të Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale në barnatore dhe **52 në depot farmaceutike**.

Paralelisht u realizuan edhe

265 inspektime


inspektime në kuadër të Praktikave të Mira Farmaceutike, gjatë të cilave u verifikua edhe vendosja e banderolës dhe përputhshmëria e çmimit të saj. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 u realizuan edhe **857 inspektime**, prej të cilave 259 përfshinë kontrollin e elementeve të banderolës

¹⁹ Po aty.

Gjatë vitit 2025, Inspektorati Farmaceutik realizoi 2,222 inspekte, prej të cilave 738 kishin për objekt kontrollin e zbatimit të Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale në barnatore dhe 52 në depot farmaceutike. Paralelisht u realizuan edhe 265 inspekte në kuadër të Praktikave të Mira Farmaceutike, gjatë të cilave u verifikua edhe vendosja e banderolës dhe përputhshmëria e çmimit të saj. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 u realizuan edhe 857 inspekte, prej të cilave 259 përfshinë kontrollin e elementeve të banderolës²⁰.

Inspektorati Farmaceutik shqiptoi 10 gjoba gjatë vitit 2025 dhe tri të tjera gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 për raste të mosvendosjes së banderolës në produktet medicinale. Prej tyre, tri gjoba në vlerë totale prej 1,500 euro iu shqiptuan barnatoreve për pranimin në qarkullim të produkteve pa banderolë, ndërsa shtatë gjoba iu shqiptuan depove farmaceutike gjatë vitit 2025 për mosvendosjen e banderolave në produkte. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, depove farmaceutike iu shqiptuan edhe tri gjoba në vlerë totale prej 5,000 euro për të njëjtën kategori shkeljesh, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Krahës tyre, përmes procesverbaleve u lëshuan edhe rekomandime dhe urdhra për eliminimin e parregullive, të cilat, sipas Ligjit për Inspektimet, përbëjnë masa parandaluese²¹.

Në anën tjetër, Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut mbikëqyri përputhshmërinë ndërmjet çmimeve të ekspozuara në barnatore dhe çmimeve të aplikuara gjatë shitjes. Gjatë vitit 2025 dhe deri në periudhën e raportimit u realizuan mbi 60 inspekte, kryesisht pas ankesave të qytetarëve për mospërputhje ndërmjet çmimit të afishuar dhe atij të evidentuar në kuponin fiskal. Si rezultat, u shqiptuan 18 gjoba në vlerë totale prej 15,800 euro, ndërsa në një rast u iniciua procedurë gjyqësore²².



GJATË VITIT 2025

Inspektorati Qendror i

Mbikëqyrjes së Tregut mbikëqyri

përputhshmërinë ndërmjet çmimeve të ekspozuara në barnatore dhe çmimeve të aplikuara gjatë shitjes. Gjatë vitit 2025 dhe deri në periudhën e raportimit u realizuan mbi

60 inspekte,

kryesisht pas ankesave të qytetarëve për mospërputhje ndërmjet çmimit të afishuar dhe atij të evidentuar në kuponin fiskal. Si rezultat, u shqiptuan **18 gjoba në vlerë totale prej 15,800 euro**

51 inspekte të përbashkëta,

ndërsa në gjashtëmujorin e parë të vitit **2026 edhe 13 të tjera**, ndërmjet Inspektoratit Farmaceutik dhe IQMT-së.

20 Të dhëna zyrtare të siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike nga Inspektorati Farmaceutik, korrik 2026.

21 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.08/L-067 për Inspektimet. Neni 20. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=53067>.

22 Të dhëna zyrtare të siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike nga Inspektorati Qendror Mbikëqyrës i Tregut, korrik 2026.

Koordinimi ndërinstitutional u reflektua edhe në inspektimet e përbashkëta. Gjatë vitit 2025 u realizuan 51 inspektime të përbashkëta, ndërsa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 edhe 13 të tjera, ndërmjet Inspektoratit Farmaceutik dhe IQMT-së.

Këto të dhëna tregojnë një rritje të aktivitetit mbikëqyrës dhe të bashkëpunimit ndërinstitutional gjatë zbatimit të ligjit.

Një sfidë e evidentuar në zbatim lidhet me rastet kur produktet medicinale shiten me çmime më të ulëta se ato të përcaktuara në banderolë. Kjo praktikë cenon zbatimin uniform të sistemit të rregullimit të çmimeve dhe mund të krijojë shtrembërime në konkurrencën ndërmjet barnatoreve²³. Po ashtu, metodologjia aktuale gjeneron çmime me vlera decimale, të cilat nuk mund të rrumbullaksohen, pasi çdo devijim do të nënkuptonte shmangie nga çmimi i përcaktuar sipas formulës ligjore.

Megjithatë, pavarësisht forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rritjes së numrit të kontroleve, korniza institucionale mbetet pjesërisht e paqartë. Ligji nuk përcakton në mënyrë eksplicite institucionin përgjegjës dhe ndarjen e kompetencave mbikëqyrëse, ndërsa funksionimi aktual mbështetet kryesisht në koordinimin praktik ndërmjet institucioneve

3.1 Zbatimi i metodologjisë në praktikë

Nga intervistat me Komisionin për Çmimin e Produkteve Medicinale rezulton se procesi aktual është më transparent dhe më i standardizuar krahasuar me fazat fillestare të zbatimit²⁴. Përmes modulit për përcaktimin e çmimeve në platformën Barnatari, aplikimet regjistrohen elektronikisht, kalojnë në validim teknik dhe më pas shqyrtohen nga Komisioni.

Verifikimi i çmimeve referente kryhet përmes burimeve zyrtare të shteteve referente, ndërsa të gjitha veprimet regjistrohen në serverët e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Pas vlerësimit publikohet lista preliminare, palëve u jepet afat për paraqitjen e ankesave dhe, pas shqyrtimit të tyre, lista zyrtare i propozohet Ministrit të Shëndetësisë për miratim. Vetëm pas përfundimit të kësaj procedure produkti pajiset me banderolë dhe mund të qarkullojë në treg. Përfaqësuesit e Odës së Farmacistëve dhe Shoqatës së Distributorëve vlerësuan se sistemi aktual ka rritur transparencën, gjurmueshmërinë dhe standardizimin e procesit të përcaktimit të çmimeve.

3.2 Sfidat gjatë vitit të parë të zbatimit

Megjithëse modeli institucional tashmë është funksional, faza fillestare e zbatimit u karakterizua nga një kombinim i vëllimit të konsiderueshëm të punës dhe kapaciteteve të pamjaftueshme teknike për administrimin e procesit. Veçanërisht, Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), si institucioni kryesor rregullator përgjegjës për regjistrimin, kontrollin e cilësisë dhe mbikëqyrjen e produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale, u përball me kapacitete të kufizuara të stafit dhe mbështetjes operationale për administrimin e reformës. Në mungesë të infrastrukturës digjitale funksionale, deklaratimet e para të çmimeve u administruan përmes tabelave në Excel dhe dokumentacionit fizik, duke rritur barrën administrative dhe duke vonuar përgatitjen e listës së çmimeve²⁵.

Zbatimi u ndikua gjithashtu nga interpretimi i metodologjisë së përcaktimit të çmimeve. Lista e parë preliminare u anulua pas procedurës së ankesave²⁶, ndërsa rikalkulimi i mijëra produkteve shtyu hyrjen në fuqi të listës përfundimtare deri më 1 shkurt 2025²⁷.

23 Diskutim tematik me akterë relevantë nga institucionet përgjegjëse dhe ekspertë të fushës, mbajtur më 28.07.2026.

24 Intervistë me Edon Muçaj, Kryetar i Komisionit për Caktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale, 22.05.2026.

25 Intervistë me Virtyte Krasniqi Shala, Drejtoreshë e Departamentit për Autorizim të Marketingut, Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), dhe anëtare e Komisionit për Caktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale.

26 Ministria e Shëndetësisë. Vendimi nr.05-4289 për anulimin e listës preliminare të çmimit të produkteve medicinale.

27 Po aty.

Periudha tranzitore u shoqërua edhe me sfida praktike për distributorë farmaceutik, përfshirë mungesën e çmimeve të deklaruar për një numër produktesh, paqartësitë lidhur me trajtimin e stoqeve ekzistuese dhe vështirësitë e përkohshme në furnizimin me disa produkte medicinale.

3.3 Perspektiva e qytetarëve

Për të vlerësuar perceptimet dhe përvojën e qytetarëve pas hyrjes në fuqi të Listës Zyrtare të Çmimeve, në kuadër të këtij hulumtimi u realizua një anketë qytetarë në gjithë Kosovën²⁸. Anketa shqyrtoi nivelin e informimit të qytetarëve për sistemin e rregullimit të çmimeve të produkteve medicinale, si dhe perceptimet e tyre mbi zbatimin e tij në praktikë.

Rezultatet tregojnë se 80% e të anketuarve janë të vetëdijshëm se çmimet e produkteve medicinale duhet të jenë të njëjta në të gjitha barnatoret. Megjithatë, 81% deklaruan se kanë hasur çmime të ndryshme për të njëjtin produkt medicinal në barnatore të ndryshme. Këto rezultate tregojnë një hendek ndërmjet objektivit të ligjit për nivelizimin e çmimeve dhe perceptimit të qytetarëve për zbatimin e tij. Me fjalë të tjera, shumica e qytetarëve e njohin standardin ligjor, por vazhdojnë të perceptojnë se ai nuk zbatohet në mënyrë konsistente në praktikë. Gjatë fazës së zbatimit, aktivitetet informuese të Ministrisë së Shëndetësisë u fokusuan kryesisht te akterët profesionalë të sistemit farmaceutik, përfshirë farmacistët, depot dhe distributorët farmaceutikë, me qëllim përshtatjen e tyre me kërkesat e reja ligjore. Megjithatë, nuk u zhvillua një fushatë e krahasueshme e informimit publik, e orientuar drejt qytetarëve, për të shpjeguar ndryshimet që solli ligji, mënyrën e funksionimit të sistemit të ri të çmimeve dhe mekanizmat në dispozicion për ushtrimin e së drejtës së ankesës²⁹.



60% e respondentëve

deklaruan se janë të informuar se çmimi zyrtar i produktit medicinal është i shënuar në banderolë, ndërsa 40% nuk e njohin këtë mekanizëm.

Duke qenë se banderola përfaqëson mekanizmin kryesor për verifikimin e çmimit të miratuar, ky nivel i informimit kufizon mundësinë e qytetarëve për të identifikuar dhe raportuar rastet e mospërputhjes së çmimeve.

Anketa evidentoi gjithashtu boshllëqe në informimin e qytetarëve për mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të tyre. Vetëm 60% e respondentëve deklaruan se janë të informuar se çmimi zyrtar i produktit medicinal është i shënuar në banderolë, ndërsa 40% nuk e njohin këtë mekanizëm. Duke qenë se banderola përfaqëson mekanizmin kryesor për verifikimin e çmimit të miratuar, ky nivel i informimit kufizon mundësinë e qytetarëve për të identifikuar dhe raportuar rastet e mospërputhjes së çmimeve.

Po ashtu, anketa evidentoi një nivel shumë të ulët të raportimit institucional. Vetëm 5% e respondentëve deklaruan se kanë raportuar ndonjëherë raste të dyshuara të mospërputhjes së çmimeve. Kjo sugjeron se mekanizmat ekzistues të raportimit mbeten pak të përdorur, qoftë për shkak të mungesës së informacionit mbi institucionet përgjegjëse dhe procedurat e raportimit, qoftë për shkak të besimit të kufizuar në efektivitetin e reagimit institucional. Mungesa e një fushate të dedikuar për informimin e publikut mbi institucionet përgjegjëse dhe procedurat e paraqitjes së ankesave ka gjasa të ketë ndikuar gjithashtu në nivelin e ulët të raportimit nga qytetarët.

28 Pyetësor anonim me qytetarë, i realizuar përmes platformës CER (Citizen Engagement Response), qershor 2026.

29 Diskutim tematik me akterë relevantë nga institucionet përgjegjëse dhe ekspertë të fushës, mbajtur më 28.07.2026.

Rezultatet e anketës tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve vazhdojnë të perceptojnë dallime në çmimet e produkteve medicinale ndërmjet barnatoreve. Megjithatë, këto perceptime duhet të interpretohen në kontekstin e zbatimit të ligjit. Gjatë periudhës tranzitore, produktet e furnizuara para hyrjes në fuqi të Listës Zyrtare të Çmimeve vazhduan të qarkullojnë me çmimet ekzistuese deri në konsumimin e stoqeve, duke krijuar përkohësisht dallime në treg.

Perceptimi ndikohet edhe nga fakti se jo të gjitha produktet në barnatore i nënshtrohen këtij ligji. Suplementet ushqimore dhe produktet e tjera jashtë fushës së zbatimit vazhdojnë të tregtohen me çmime të lira, ndërsa një pjesë e ankesave të adresuara në Inspektoratin Farmaceutik lidhen pikërisht me këto produkte³⁰. Gjithashtu, 82% e të anketuarve deklaruan se kanë blerë produkte pa banderolë, çka mund të lidhet me produkte jashtë sistemit të rregullimit, me stoqe të krijuara para hyrjes në fuqi të listës ose me raste të mospërputhjes në zbatim.



Po ashtu, anketa evidentoi një nivel shumë të ulët të raportimit institucional. Vetëm

5% e respondentëve

deklaruan se kanë raportuar ndonjëherë raste të dyshuara të mospërputhjes së çmimeve.

30 Intervistë me Labinot Zeqirin, Zëvendësues i Kryeinspektorit Shëndetësor; Remzie Thaqin, Kryeinspektore Farmaceutike; dhe Edon Muçaj, Inspektor Farmaceutik, Ministria e Shëndetësisë, 10.07.2026.

4. Ndikimi i ligjit në dimensionet e tjera

4.1. Ndikimi në çmimet e produkteve medicinale

Rregullimi i çmimeve të produkteve medicinale është prezantuar në diskursin publik edhe si mekanizëm që do të ulte çmimet e barnave për qytetarët³¹. Megjithatë, analiza e Listës Zyrtare të Çmimeve dhe përditësimeve të saj tregon se ndikimi në çmime nuk ka qenë uniform. Zbatimi i metodologjisë ka rezultuar me ulje të çmimeve për një numër produktesh, por edhe me rritje për produkte të tjera, varësisht nga rezultatet e metodologjisë së referencës së jashtme dhe çmimet referente të disponueshme.

Në listën e parë të çmimeve janë evidentuar ulje të konsiderueshme për disa produkte medicinale. Për shembull, çmimi i Lisinopril është ulur nga 4.60 euro në 2.54 euro, Doxorubicin nga 25.00 euro në 10.75 euro, ndërsa Ephedrine nga 30.00 euro në 5.81 euro. Në të njëjtën kohë, për produkte të tjera janë evidentuar rritje të çmimeve. Krahasimi ndërmjet listës së përditësuar më 24 mars dhe asaj të 4 prillit 2025 tregon se, ndër të tjera, çmimi me pakicë i Paracetamol 120 mg/5 ml është rritur nga 1.46 euro në 2.17 euro, ndërsa ai i Diazepam 10 mg/2 ml (10 ampula) nga 1.42 euro në 2.44 euro³².

Këto ndryshime tregojnë se efekti i ligjit nuk duhet të vlerësohet vetëm përmes uljes ose rritjes së çmimeve të produkteve individuale. Objektivi kryesor i Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale është vendosja e një metodologjie të standardizuar për përcaktimin e çmimeve dhe nivelizimi i tyre në të gjitha barnatoret, e jo garantimi i uljes lineare të çmimeve për të gjitha produktet medicinale.



Në listën e parë të çmimeve janë evidentuar ulje të konsiderueshme për disa produkte medicinale.

Lisinopril	4.60 euro	↘	2.54 euro,
Doxorubicin	25.00 euro	↘	10.75 euro,



Në të njëjtën kohë, për produkte të tjera janë evidentuar rritje të çmimeve. Krahasimi ndërmjet listës së përditësuar më 24 mars dhe asaj të 4 prillit 2025 tregon se, ndër të tjera, çmimi me pakicë:

Paracetamol 120 mg/5 ml	1.46 euro	↗	2.17 euro,
Diazepam 10 mg/2 ml (10 ampula)	1.42 euro	↗	2.44 euro

31 "Vitia për çmimet e barnave: Do të jenë të njëjta kudo dhe më të ulëta". Koha.net Gjendet në: <https://www.koha.net/arberi/vitia-per-cmimet-e-barnave-do-te-jene-te-njejta-kudo-dhe-me-te-uleta>.

32 Përditësohet sërish lista e çmimeve të barnave – rritet kostoja e disa ilaçeve, të tjerat mbesin të njëjta. Telegrafi. Gjendet në: <https://telegrafi.com/perditesohet-serish-lista-e-cmimeve-te-barnave-nga-msh-rritet-kostoja-e-disa-ilaceve-te-tjerat-mbesin-te-njejta/>.

Si rezultat, ndikimi i reformës në çmime është i diferencuar dhe pasqyron zbatimin e metodologjisë së referencës së jashtme, e cila, varësisht nga produkti dhe çmimet referente, mund të prodhojë si ulje ashtu edhe rritje të çmimeve.

4.2 Disponueshmëria e produkteve medicinale

Hyrja në fuqi e Listës Zyrtare të Çmimeve më 1 shkurt 2025 u shoqërua me sfida të përkohshme në disponueshmërinë e disa produkteve medicinale, si në tregun privat ashtu edhe në institucionet publike shëndetësore³³. Gjatë periudhës tranzitore u raportuan mungesa të përkohshme të disa produkteve, veçanërisht të tretësirave infuzive si NaCl dhe glukozja, duke nxitur diskutime mbi ndikimin e modelit të ri të rregullimit të çmimeve në furnizimin e tregut³⁴.

Intervistat tregojnë se institucionet dhe distributorët farmaceutik ofrojnë shpjegime të ndryshme për këto mungesa³⁵. Përfaqësuesit e distributorëve i lidhën ato me çmimet e miratuara dhe vështirësitë për të siguruar furnizim ekonomikisht të qëndrueshëm për disa produkte. Në anën tjetër, Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet përgjegjëse vlerësuan se mungesat ishin kryesisht pasojë e mosdeklarimit me kohë të çmimeve nga një pjesë e distributorëve. Meqenëse produktet që nuk kishin përfunduar procedurën e deklarimit të çmimit nuk mund të pajiseshin me banderolë dhe të qarkullonin ligjërisht në treg, kjo ndikoi përkohësisht në disponueshmërinë e tyre.

4.3 Zbatimi i ligjit në prokurim publik

Ligji për Çmimin e Produkteve Medicinale përcakton se Lista Zyrtare e Çmimeve me Shumicë shërben si bazë për përcaktimin e çmimit të blerjes së produkteve medicinale nga institucionet publike, ndërsa çmimi me shumicë përfaqëson çmimin maksimal të shitjes nga distributori, pa TVSH³⁶. Në praktikë, kjo nënkupton se procedurat e prokurimit publik mund të rezultojnë me çmime më të ulëta përmes konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, por jo me çmime që tejkalojnë kufirin maksimal të përcaktuar në listën zyrtare.

Analiza e procedurave të prokurimit mbështet këtë interpretim, pasi identifikon një numër rastesh ku produktet medicinale janë kontraktuar me çmime dukshëm më të ulëta se ato të publikuara në Listën Zyrtare të Çmimeve me Shumicë. Për shembull, produkti Gliclazide³⁷ është kontraktuar me 0.12 euro për njësi, ndërsa në listën zyrtare figuron me 3.44 euro³⁸. Në mënyrë të ngjashme, Ascorbic Acid është kontraktuar me 0.10 euro³⁹, ndërsa çmimet e publikuara në listën zyrtare për të njëjtin produkt variojnë nga 0.37 euro deri në 15.22 euro⁴⁰, varësisht nga prodhuesi.

Një shpjegim i mundshëm për këto dallime lidhet me natyrën e prokurimit publik dhe mënyrën e furnizimit. Në rastin e kontratave publike, operatorët ekonomikë kanë një nivel më të lartë sigurie për realizimin e shitjes, pasi furnizimi bazohet në kontrata të lidhura paraprakisht me institucione publike. Kjo mund t'u krijojë hapësirë për të negociuar çmime më të favorshme me prodhuesit ose furnizuesit, duke reflektuar këto ulje edhe në ofertat e paraqitura në procedurat e prokurimit⁴¹.

33 Intervistë me Virtyte Krasniqi Shala, Drejtoreshë e Departamentit për Autorizim të Marketingut, Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKP-PM), dhe anëtare e Komisionit për Caktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale, 03.06.2026.

34 Telashet e furnizimit me NaCl, Ministria e Shëndetësisë thotë se nuk ka mungesa në sektorin publik. Telegrafi. Gjendet në: <https://telegrafi.com/telashet-e-furnizimit-nacl-ministria-thote-se-nuk-ka-mungesa-ne-sektorin-publik/>.

35 Diskutim në fokus grup me aktërë relevantë nga institucionet përgjegjëse dhe ekspertë të fushës, mbajtur më 14.07.2026.

36 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale. Neni 14. Gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=79015>.

37 Kontrata nr. 206-26-1533-1-1/C1037, e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Santeopharm Sh.p.k., më 08.05.2026. Gjendet në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327>.


38 Ministria e Shëndetësisë, "Lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale – Versioni 1.16", 01.04.2026. Gjendet në: <https://msh.rks-gov.net/Documents/Index/267>.

39 Kontrata nr. 206-26-1533-1-1/C1039, e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe MATKOS PHARM Sh.p.k., më 08.05.2026. Gjendet në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327>.

40 Ministria e Shëndetësisë, "Lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale – Versioni 1.16", 01.04.2026. Gjendet në: <https://msh.rks-gov.net/Documents/Index/267>.

41 Argument i ngritur nga Shoqata e Distributorëve të Produkteve Farmaceutike dhe Medicinale të Kosovës në diskutimin tematik të datës 28.07.2026.

Sekuestrimi i barnave



4.4 Kontrabanda dhe qarkullimi jashtë sistemit

Një nga arsyetimet që ka shoqëruar miratimin e Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale ishte se nivelizimi i çmimeve mund të reduktonte stimujt ekonomikë për kontrabandimin e produkteve medicinale. Në teori, zvogëlimi i dallimeve të çmimeve ndërmjet Kosovës dhe vendeve të rajonit mund të kufizojë përfitimin ekonomik nga tregtia e paligjshme. Megjithatë, ndikimi i politikës së çmimeve në kontrabandë nuk mund të vlerësohet vetëm përmes të dhënave mbi konfiskimet.

Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se produktet medicinale vazhdojnë të konfiskohen edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit. Gjatë vitit 2022 janë sekuestruar 315.32 kg barna me vlerë 47,179.59 euro, në vitin 2023 1,001.30 kg me vlerë 86,946.53 euro, në vitin 2024 718.92 kg me vlerë 81,729.31 euro, ndërsa në vitin 2025 1,823.30 kg me vlerë 93,300.04 euro⁴². Këto të dhëna tregojnë se kontrabanda e produkteve medicinale mbetet e pranishme, por nuk lejojnë të nxirren përfundime mbi efektin e rregullimit të çmimeve në nivelin e saj. Numri dhe vlera e konfiskimeve ndikohen nga një sërë faktorësh, përfshirë intensitetin e kontrolleve doganore, kapacitetet e zbatimit të ligjit dhe modelet e kontrabandës, prandaj nuk mund të përdoren si tregues i drejtpërdrejtë i efektivitetit të politikës së çmimeve.

Në këtë kontekst, rregullimi i çmimeve duhet të shihet si vetëm një komponent i politikës për integritetin e tregut farmaceutik. Parandalimi i qarkullimit të produkteve jashtë sistemit kërkon mekanizma efektivë të mbikëqyrjes përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit, koordinim ndërinstucional dhe funksionalizimin e sistemit Track & Trace, i cili do të mundësonte gjurmueshmërinë e produkteve medicinale nga importi deri te pacienti dhe do të forconte kapacitetet për identifikimin e produkteve që qarkullojnë jashtë kanaleve të autorizuara.

⁴² Të dhëna zyrtare të siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike nga Dogana e Kosovës, korrik 2026.

Rekomandime

Ligji për Çmimin e Produkteve Medicinale përbën reformën e parë gjithëpërfshirëse për rregullimin administrativ të çmimeve të barnave në Kosovë dhe ka krijuar bazën ligjore për standardizimin e çmimeve në tregun farmaceutik. Megjithatë, përvoja e rreth një viti e gjysmë të zbatimit ka evidentuar një sërë çështjesh juridike, institucionale dhe praktike që mund të adresohen përmes rishikimit të kuadrit ligjor dhe politikave zbatuese. Rekomandimet në vijim synojnë të forcojnë efektivitetin, fleksibilitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit, duke ruajtur objektivat themelore të ligjit dhe duke reflektuar mësimet e nxjerra nga faza fillestare e zbatimit.

- Rishikimi i Ligjit për Çmimin e Produkteve Medicinale për të përcaktuar qartë kompetencat institucionale për mbikëqyrjen e zbatimit të tij, duke eliminuar paqartësitë lidhur me institucionin përgjegjës dhe ndarjen e mandateve.
- Krijimi i një baze ligjore për përdorimin e mekanizmave alternativë të përcaktimit të çmimeve, përfshirë mundësinë e negociimit të drejtpërdrejtë me prodhuesit në rrethana të interesit publik, si emergjencat shëndetësore ose sigurimi i produkteve strategjike.
- Rishikimi i metodologjisë për përcaktimin e çmimeve me shumicë, duke vlerësuar përshtatshmërinë e marzhës maksimale prej 7.5% dhe duke përcaktuar qartë përmbajtjen e “shpenzimeve të tjera vartëse”, në mënyrë që modeli të reflektojë kostot reale të furnizimit dhe të mos dekurajojë operatorët ekonomikë.
- Plotësimi i kornizës ligjore për trajtimin e produkteve në qarkullim pas përditësimit të Listës Zyrtare të Çmimeve, duke përcaktuar rregulla të qarta për vlefshmërinë e banderolës, trajtimin e stoqeve ekzistuese dhe përparësinë ndërmjet çmimit në banderolë dhe atij në Listën Zyrtare të Çmimeve.
- Rishqyrtimi i përfshirjes së produkteve OTC në sistemin e rregullimit administrativ të çmimeve, duke vlerësuar një model më të diferencuar që fokusohet kryesisht te barnat me recetë dhe produktet e financuara nga fondet publike, në përputhje me praktikatat evropiane.
- Ribalancimi i arkitekturës institucionale të ligjit, duke kufizuar varësinë e funksionimit të sistemit nga vendimmarrja e Ministrit të Shëndetësisë dhe duke përcaktuar qartë elementet që duhet të rregullohen përmes akteve nënligjore, me qëllim rritjen e fleksibilitetit dhe parashikueshmërisë së sistemit.
- Parashikimi në ligj i funksionalizimit të mekanizmave të gjurmueshmërisë së produkteve medicinale (Track & Trace) dhe integrimi i tyre me sistemin e rregullimit të çmimeve, për të forcuar monitorimin e zbatimit, integritetin e zinxhirit të furnizimit dhe luftimin e qarkullimit të paligjshëm.
- Institucionalizimi i informimit publik për funksionimin e sistemit të çmimeve, duke obliguar institucionet përgjegjëse që, krahas informimit të operatorëve ekonomikë, të zhvillojnë fushata të rregullta informuese për qytetarët mbi të drejtat e tyre dhe mekanizmat për verifikimin e çmimeve.

